




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Punijeno/Protato Received/Delivry	29-05-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Rr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMVBK	4590/2023		1/6



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.585/2023**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.585/2023 të datës 30.03.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 29.05.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.585/2023 e datës 30.03.2023 e parashtruar nga ankuesi**
- II. Shfuqizohet Vendimi Nr.KVLBK/01/2023 i Komisionit për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë të Policisë së Kosovës i datës 28.03.2023.**
- III. Anulohet konkursi i shpallur nga Policia e Kosovës sipas njoftimit të datës 21.12.2022 me numër reference RN00010577 dhe të gjitha vendimet/aktet administrative që rrjedhin nga kjo procedurë e këtij konkursi.**
- IV. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës , të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.**
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

## A r s y e t i m

Policia e Kosovës duke u bazuar në dispozitat e nenit 38(1,2,3 dhe 4) të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Lëvizje Brenda Kategorisë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datën 21.12.2022 ka shpallur konkursin e brendshëm për pozitën Zyrtar i lartë për Zhvillimin e performancës” me numër të referencës RN00010577 në Ministrinë e Punëve të Brendshme/Policia e Kosovës, për klasën e pozitës Profesional 1.

Ankuesi me datën 18.01.2023 ka aplikuar në konkursin e lartcekur, në të cilën procedurë ka qenë i përfshirë në intervistë. Pas përfundimit të intervistës në konkursin e brendshëm -Lëvizje Brenda Kategorisë për pozitën Zyrtar i lartë për Zhvillimin e performancës, klasa Profesional 1, me nr.ref.RN00010577 i shpallur me datën 05.01.2023 deri me datën 19.01.2023, Pas përfundimit të intervistës në konkursin e brendshëm-lëvizje brenda kategorisë, Drejtoria e Personelit në Policinë e Kosovës publikon emrin e kandidatit fitues të rekomanduar nga Komisioni i Vlerësimit me njoftimin e datës 28.03.2023 me nr.referencës 07/1-01SAP-R/046/2023.

I pa kënaqur me rezultatet e vlerësimit nga ana e komisionit të vlerësimit, me datën 22.03.2023, ankuesi ka parashtruar ankesë tek Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë , me pretendimet ankimore, shkelje të dispozitave të Rregulloresë(QRK) Nr.16/2020 për Pranim dhe Karrierë në Shërbimin Civil.

Komisioni i vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë me datë 28.03.2023 nxjerr vendimin me Nr.KVLBK/01/2023 me të cilin i refuzohet ankesa e ankuesit si e pabazuar.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë , të Ministrisë së Punëve të Brendshme/Policia e Kosovës lidhur me refuzimin e ankesës së tij, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 30.03.2023, ka parashtruar ankesën me numër protokollit 3132/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 31.03.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë me numër protokollit 3219/2023 tek Policia e Kosovës, ndërsa me datën 20.04.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga kjo e fundit me numër protokollit 3731/2023 bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën e ankuesit me numër protokollit 3132/2023 të datës 30.03.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi për themelimin e Komisionit Disiplinor i datës 11.05.2022; Vendimi për grupit punues për hartimin e formave standarde të vendimeve i datës 24.08.2021; Vendimi për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit të Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik; Vendimi i datës

29.12.2022 A.nr.971/2022 me numër protokolli 8595/2023 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Historia e punësimit; Ankesa ndaj Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje brenda kategorisë; Vendimi me numër KVLBK/01/2023 i datës 28.03.2023 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Policinë e Kosovës; Kopja e konkursit e datës 05.01.2023; Njoftimi për listën e ngushtë i datës 03.02.2023; E-mail zyrtar i datës 17.03.2023-rezultati i intervistës i datës 16.03.2023; Njoftimi i datës 28.03.2023; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 20.04.2023 me numër protokolli 3731/2023 bashkë me shkresat e lëndës; Vendimi i datës 04.12.2019 për sistemim për kohë të pacaktuar; kërkesë për aprovim për fillimin e procedurës për sh 10palljen e konkursit 14 e 1 brendshëm –lëvizje brenda kategorisë e datës 16.09.2022; Lista e aplikantëve; lista e kandidatëve të aprovuar; Aplikacioni i datës 18.01.2023 për Diploma e datës 11.07.2014 me Nr.709/14 e lëshuar nga Kolegji AAB në Prishtinë; Çertifikatë e datës 26.09.2022; Mirënjohje e vitit 2022 nga Policia e Kosovës; Letër falënderimi; Çertifikatë e datës 11-12-22 mars 2019; Çertifikatë e datës 12-15.10.2017; Çertifikatë 01-05 qershor 2015; Çertifikatë e datës 27-31 maj 2014; Çertifikatë 14-15 shkurt 2017; Çertifikatë e datës 10-13 gusht 2012; Çertifikatë e datës 06.07.2012; Çertifikatë e datës 01.11.2011; Çertifikatë e muajit dhjetor 2010; Vërtetim punësimi datës 25.05.2022; vërtetim punësimi i datës 25.05.2022; Letër reference e datës 24.05.2022; Kopja e letërnjoftimit; Formulari për vlerësimin e rezultateve për vitin 2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022; Çertifikatë mbi dënimet penale e datës 17.01.2023; vërtetim i datës 17.01.2023; Aplikacioni i datës 19.01.2023 për Dëftesat e shkollës së mesme; Diploma e datës 24.09.2014 me nr.3482 e lëshuar nga Fakulteti Filozofik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtinës”; Diploma Master e datës 25.07.2018 me nr.1101 e lëshuar nga Fakulteti Filozofik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina; Çertifikatë e datës 26.06.2018; Çertifikatë e datës 18-21.02.2014; Çertifikatë e datës 30.01.2014; Çertifikatë e datës 23.01.2019; Çertifikatë e datës 11.07.2010; Çertifikatë e datës 03.06.2008; Vërtetim punësimi i datës 18.01.2023; Letër reference e datës 12.10.2023; Letër reference e datës 12.01.2023; Rekomandim lidhur me znj. nga Prishtina nga AKP; Rekomandim i datës 21.07.2014 nga AKP; Shkresa e datës 08.07.2011 se ka kryer praktikën gjashtë mujore në Ministrinë e Integriteteve Evropiane; Kopja e letërnjoftimit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021; Vërtetim i datës 11.01.2023; Çertifikatë mbi dënimet penale i datës 13.01.2023; Njoftim i datës 24.01.2023 për listën e shkurtër; Njoftimi i datës 03.02.2023 për verifikimin paraprak; Vendim për themelimin e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë i datës 10.03.2023; Renditja përfundimtare e kandidatëve dhe Njoftimi i datës 17.03.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, mbi bazën e shkresave të administruara të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka konstatuar se Policia e Kosovës me datë 21.12.2022 ka shpallur konkursin lëvizje brenda kategorisë me numër Reference: RN00010577, për pozitën “Zyrtar i Lartë për Zhvillimin e Performancës dhe Karrieres”, ndërsa kërkesat e përgjithshme formale të konkursit kanë qenë:

- *Arsinimi i kërkuar: Diplome/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (në rastin kur kredit janë mbledhur si pasojë e diplomës Bachelor dhe Master, fushës e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i diplomës Bachelor), në*

*drejtimet shkencat shoqërore, Juridik, Ekonomik, Administratë publike, Burime njerëzore si dhe drejtime tjera relevante.*

- *Kualifikimi të posaçme formale: Përvoja e punës së kërkuar: Se paku dy (2) vite përvoja pune profesionale në fushën për të cilin zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Ndërsa, përveç kritereve të parapara në konkursin e datës 05.01.2023 kanë qenë të përcaktuara edhe kushtet dhe dokumentacioni i nevojshëm për pranimit të aplikacioneve sikurse përcaktohet në pikën 2. **Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë:** *“Të jetë nëpunës civil i së njëjtës kategori për të cilën aplikon, të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale, Të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende, Të jetë vlerësuar të paktën “mirë” për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit, Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.”*, ndërsa në pikën 5. **Dokumentacioni që duhet të paraqitet për aplikim:** *“Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; Kopjet e dëshmisë së punësimit, Kopjet e dëshmisë së pranimit, Kopjet e vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit dhe Dokumentet që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende”*.

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e administruara të lëndës, gjegjësisht sipas Vendimit të datës 03.12.2019 me nr.ref.07/1-01SAP-P/10527, ka konstatuar se ankuesi mban pozitën e punës “Zyrtar i Arkivit”, në kuadër të Drejtorisë së Personelit dhe Administratës në Policinë e Kosovës, ndërsa sipas aplikacionit të datës 18.01.2023 konstatohet fakti se i njëjti ka aplikuar në konkursin e numër të Referencës: RN00010577 për pozitën e punës “Zyrtarë i Lartë për zhvillimin e Performancës dhe Karrieres” të shpallur nga Policia e Kosovës, ndërsa sipas formularit të vlerësimit përfundimtar për të gjithë kandidatët i datës 16.03.2023, ankuesi nuk rezulton të jetë kandidatë i suksesshëm.

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i këshillit ka gjetur se sipas listës së aplikantëve , në konkursin e lartcekur kanë aplikuar tetë (8) kandidatë, prej të cilëve pas verifikimit paraprak të kryer nga Njësia e Pranimit tre (3) prej tyre u janë aprovuar aplikacionet dhe i janë nënshtruar procedurës së rekrutimit dy(2) prej tyre, ndërsa njëri prej kandidatëve nuk ka marrë pjesë në intervistë. Kolegji i Këshillit po ashtu ka gjetur se dy (2) prej kandidatëve të cilët kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak i kanë plotësuar kriteret e përgjithshme formale të konkursit të datës 05.01.2023 për pozitën “Zyrtar i Lartë për Zhvillimin e Performancës dhe Karrierës “, mirëpo bazuar në shkresat e lëndës, duke analizuar dokumentacionin e kandidatës fituese konstatohet se në bazë të kontratës së punës të datës 06.06.2012 është e punësuar në Policinë e Kosovës në pozitën e punës “Asistent Administrativ” me përshkrimin e detyrave të punës “Merr shënime dhe shkresa dhe i shqyrton ato. Shqyrton postën hyrëse dhe përgatit shënime të shkurtra për kryesuesin/drejtorin duke nënvizuar idetë kryesore në dokumente. Përpilon shkresa të thjeshta për përgjigje për dhe në emër të kryesuesit/drejtorit.....”, andaj mbi këtë bazë konstatohet fakti se kandidatja përvojën e punës nuk e ka në fushën për të cilën është zhvilluar procedura e rekrutimit e që është njëri nga kriteret bazë të konkursit, nga se në konkurs ishte paraparë kriteri si në vijim:” *Përvoja e punës së kërkuar: Se paku dy (2) vite përvoja pune profesionale në fushën për të cilin zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës”*.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë pretendimeve ankimore të ankuesit sikurse edhe të gjeturave të konstatuara si më lartë, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës neni 41 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 si dhe paragrafi 3 ku përcaktohet se: *“Për të aplikuar për lëvizjen brenda kategorisë, duhet të plotësohen së bashku, kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën zhvillohet procedura e konkurrimit. 2.Kushtet që duhet ti plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 3. Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për konkurrim për lëvizjen brenda kategorisë”,* si dhe neni 45 paragrafi 1 dhe 5 i së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *“1 .Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurrohet. 5. Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të aplikimeve”* dhe ka ardhur në përfundimin se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me rastin e përfshirjes së kandidatëve në listën e ngushtë të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara të konkursit, kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e neni 38 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Në procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për kategorinë profesionale mund të aplikojnë vetëm nëpunësit e kësaj kategorie, të konfirmuar sipas nënparagrafi 4.1 të neni 37 të këtij ligji.”*

Prandaj, nga se u tha si më lartë Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit duke u bazuar në neni 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative sipas detyrës zyrtare ka shqyrtuar ligjshmërinë e këtij procesi dhe ka konstatuar se Drejtoria e Personelit në Policinë e Kosovës, me rastin e përpilimit të listës së ngushtë të kandidatëve ka bërë shkelje të procedurave të rekrutimit për faktin që përveç kandidatja fituese që nuk i ka plotësuar kushtet për të qenë në listë të ngushtë poashtu as ankuesi me rastin e aplikimit në pozitën e lartë nuk ka plotësuar kriteret e konkursit sepse nuk e ka përvojën e punës në fushën për të cilën është zhvilluar procedura e rekrutimit e që është njëri nga kriteret e konkursit, ndërsa kjo konfirmohet në përshkrimin e detyrave që parashihen në kontratën e punës së ankuesit që është e nënshkruar më datë 02.04.2014,përshkrimin e detyrave në formularin e datës 04.09.2015,si dhe në vetë përmbajtjen e ankesës, ku janë përshkrue detyrat e punës që i kryen ankuesi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar se kandidatja fituese dhe ankuesi sipas përshkrimit të elaboruar si më lartë nuk i kanë plotësuar kushtet për të qenë në listën e ngushtë e rrjedhimisht edhe nuk i kanë plotësuar kriteret për këtë pozitë ,andaj mbi këtë bazë u konstatue se kjo procedurë është zhvilluar në kundërshtim me neni 38 paragrafin 1,2,3 dhe 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si rrjedhojë njoftimi i datës 28.03.2023 me nr.reference )7/1-01SAP-R/046/2023 për kandidatin e suksesshëm për pozitën Zyrtar i lartë për zhvillimin e performancës dhe karrierës në Policinë

e Kosovës është i pavlefshëm sipas Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa nuk u lëshua në pretendimin sa i përket çështjes së konfliktit të interesit të një anëtare të komisionit për faktin se kjo procedurë është anuluar dhe se nuk ka qenë me ndikim në këtë vendimmarrje dhe se po ashtu kompetentë për të konstatuar konfliktin e interesit është Agjencioni Kundër Korrupsionit, ndërsa kolegji nuk ka vërejt se ka pasur veprime administrative që në procedura ligjore të konstatohet konflikti i interesit.


Andaj, marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës si dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.585/2023, datë 29/05/2023.

Sabile Avdyli



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

